



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 662/1 prot.

Tiranë, më 29.04.2021

V E N D I M

Nr. 25 dt. 29.04 2021

“PËR

**MIRATIMIN PARAPRAK PËR RIORGANIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT
TË CIKLIT TË TRETË DOKTORATË , NË SHKENCA SPORTIVE,
NË DEPARTAMENTIN E SHKENCAVE SOCIALE DHE EDUKIMIT,
NË FAKULTETIN E SHKENCAVE TË LËVIZJES”**

Në zbatim të pikës 3/c,ç të nenit 3, 1/dh, të nenit 49, të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të pikës d, nenit 43, të pikës 3, germa c, neni 7, të Statutit të UST-së, VKM nr. 329 datë 12.04.2017 ”Për trajtimin e veçantë të personelit akademik”, pika 14/a ,b, pika 15/c, pika 18, Rregullores së UST, neni 30/1, Vendimi i Senatit nr. 78 datë 29.04.2021, Bordi i Administrimit në mbledhjen e tij të datës 29.04.2021

V E N D O S I :

1. Miratimin paraparak, për riorganizimin e programit të studimit të ciklit të tretë, Doktoratë në ”Shkenca Sportive”, në Departamentin e Shkencave Sociale dhe Edukimit, Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes, në Universitetin e Sporteve të Tiranës, sipas dokumentacionit bashkëngjitur.
2. Universiteti i Sporteve të Tiranës mbështet anëtarët e stafit të tij akademik në 25 % të koston së studimeve të doktoratës si pjesë e kontributit për kërkimin shkencor dhe përparimin akademik.
3. Miraton tarifën e studimit të ciklit të tretë Doktoratë, në Shkenca Sportive, sipas tabelës bashkëngjitur.
4. Ky vendim i përcillet Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë për miratim përfundimtar.
5. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare www.ust.edu.al dhe tek trasparenca universitare.

KRYETARI I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

HYSEN DOMI



Tabela e tarifave të shkollimit për ciklin e tretë të studimeve

| Nr. | Fakulteti | Emërtimi i programit të studimit | Cikli i programit të studimit | Tarifa e shkollimit (për kandidatët nga stafi efektiv) në lekë | Tarifa e shkollimit për të tjerë (në lekë) |
|-----|--------------------------------------------------|----------------------------------|-------------------------------|----------------------------------------------------------------|--------------------------------------------|
| 1 | Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit | Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti | Cikli i tretë | 600000 | 800000 |
| 2 | Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes | Shkenca Sportive | Cikli i tretë | 600000 | 800000 |